



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
DREJTORIA LIGJORE

Tiranë, më 05.10.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbimi i Transportit, Shoqërimit dhe ruajtjes së vlerave monetare gjatë transportit, me roje të kategorisë 1.3.B”, Marrëveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Shërbime roje/shërbime me roje

VLERA E FONDIT LIMIT: 502,240,630 (pesëqind e dy milion e dyqind e dyzet mijë e gjashtëqind e tridhjetë) Lekë, pa TVSH

Në Euro: 4,738,566.18 (katër milion e shtatëqind e tridhjetë e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë tetëmbëdhjetë) Euro, pa TVSH.

Sipas kursit zyrtar të këmbimit 1 (një) EURO këmbëhet me 105.99 Lekë, datë 04.10.2023.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **SH.A. Posta Shqiptare**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. Sigurimin e Ofertës, në vlerën **10,044,812.6 Lek** (dhjetë milion e dyzet e katër mijë e tetëqind e dymbëdhjetë pikë gjashtë). ose
Ne Euro **94,771.32** (nëntëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e një) Euro.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve te fundit 2020, 2021 dhe 2022, **ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 190% të vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohe, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se 39% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar ku të ***ketë një numer mesatar prej 120 (njëqind e njëzetë) punonjësish të siguruar për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit***, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët

E-sig 025 a) për këtë Përiudhë të konfirmuara elektronikisht nga organet tatimore, si dhe stafi drejtues (Administratori dhe Drejtuesi Teknik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: *Referuar specifikimeve teknike ku kërkohet ofrim shërbimi në të 12 qarqet, ku kërkohet disponimi i 56 automjeteve me 56 shofera me minimum nga një shoqërues për automjet, ndërkohë që në raste të caktuara në varësi të sasisë së vlerave monetare që do të transportohen dhe sipas normës së automjetit të blinduar, referuar në KREU VI, Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve të Sektorit Bankar, Sigurimi dhe Shoqërimi i Vlerave Monetare, Materiale dhe Sendeve të Çmuara gjatë Transportit, germa C) Kategorizimi i automjeteve të blinduara dhe shoqëruese, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme, duhen më shumë se një shoqërues për automjet, duke përfshirë titullarin e shoqërisë, drejtuesin teknik dhe stafin e qendrave të kontrollit, disponimi i një numri prej 120 (njëqind e njëzetë) punonjësish të siguruar është numri minimal i kërkuar, për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën.*

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 (këstet e maturuara), në të gjitha vendet e ushtrimit të aktivitetit sipas Regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit.

Argumentimi: Në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në KREU II, TAKSAT VENDORE, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin E Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që disponon Certifikatë të titullarit të subjektit në fushën e veprimtarisë së aktivitetit 1.3 B, lëshuar nga Dr. e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bazë të ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) të ndryshuar si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, germa a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 14/b të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike dhe në Kreun I, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme.

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshem dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën

2.3.5 Operatori Ekonomik *ofertues* duhet të vërtetojë që disponon Certifikatë e drejtuesit teknik në fushën e veprimtarisë aktivitetit 1.3 B, lëshuar nga Dr. e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në bazë të ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) të ndryshuar si dhe akteve nenligjore të dala në zbatim të tij).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 14/c të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike dhe në Kreun I, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme.

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshem dhe zotërojnë kapacitetet profesionale për të zbatuar kontratën

2.3.6 Operatori Ekonomik *ofertues* duhet të vërtetojë që disponon Licensë/Autorizim për ngritjen dhe shfrytëzimin e sistemit të pavarur të radiokomunikacionit të lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Postare dhe Elektronike (AKEP) konform Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” për vitin 2021, me fushë mbulimi në qarkun ose qytetet ku ndodhen objektet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 14/c të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në pikën D. Qendra e Kontrollit, të Kreut VII, Uniformat, mjetet, pajisjet e shërbimit, dokumenti I identifikimit të punonjësve të SHPSF-SË, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrisë të Brendshme dhe në pikën 1, të Neni 65 Përdorimi i frekuencave, të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se: Personat fizikë apo juridikë mund të përdorin frekuencë vetëm pasi të jenë pajisur, paraprakisht, me autorizim nga AKEP-i, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshem dhe zotërojnë kapacitetet teknike (pajisjet e shërbimit) për të zbatuar kontratën.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 56 (pesëdhjetë e gjashtë) automjete të blinduar për transportin e vlerave monetare, mjete të cilat duhet të jenë në pronësi të operatorit ekonomik ose me qera. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Lejet e qarkullimit dhe certifikat pronësie nga Drejtoria e Transportit Rrugor
- b) Leje Drejtimi e përdoruesit të mjetit të blinduar për çdo mjet.
- c) Çertifikatë e Kontrollit Teknik për secilin mjet (SGS).
- d) Siguracion të vlefshëm për secilin mjet.
- e) Taksat vjetore të paguara për secilin mjet.

Numri i mjeteve të blinduara të kërkuara sipas qarqeve, si më poshtë, të vërtetohet nga vërtetimi i performances i lëshuar, nga Drejtoritë e Policisë të secilit Qark.

Për Qarkun Tiranë 10 mjete të blinduara.

Për Qarkun Durrës 5 mjete të blinduara.

Për Qarkun Shkodër 5 mjete të blinduara.

Për Qarkun Lezhë 4 mjete të blinduara.

Për Qarkun Fier 6 mjete të blinduara.

Për Qarkun Berat 3 mjete të blinduara.

Për Qarkun Vlorë 4 mjete të blinduara.

Për Qarkun Gjirokastër 3 mjete të blinduara.

Për Qarkun Elbasan 6 mjete të blinduara.

Për Qarkun Kukës 2 mjete të blinduara.

Për Qarkun Peshkopi 3 mjete të blinduara.

Për Qarkun Korçë 5 mjete të blinduara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ç,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në pikën 1 të nenit 32 të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në KREU VI, Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve të Sektorit Bankar, Sigurimi dhe Shoqërimi i Vlerave Monetare, Materiale dhe Sendeve të Çmuara gjatë Transportit, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.

Konkretisht: Referuar specifikimeve teknike ku kërkohet ofrim shërbimi në të 12 qarqet, si dhe referuar numrit të prekjeve sipas filialeve dhe zyrave postare është parashikuar disponimi i 56 automjeteve të blinduara, kjo edhe për faktin se kemi një shtrirje në 34 Filiale dhe degë postare ndërkohë që në qendra prefekturash duhet një numër më i lartë automjetesh si dhe referuar faktit që koha e ofrimit të shërbimit, është në mëngjes heret për furnizimin e zyrave postare me vlera monetare, me qëllim shmangien e radhëve të qytetarëve nëpër sportele, dhe në pjesën e dytë të ditës për grumbullimin e parave të arkëtuara nga shërbimet financiare të realizuara.

Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponoje 56 (pesëdhjetë e gjashtë) Autorizime të vlefshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për përdorimin e mjeteve të blinduara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, germa a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në pikën 1 të nenit 32 të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në KREU VI, Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve të Sektorit Bankar, Sigurimi dhe Shoqërimi i Vlerave Monetare, Materiale dhe Sendeve të Çmuara gjatë Transportit, germa B), pika 5, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.

Konkretisht: *Referuar specifikimeve teknike ku kërkohet ofrim shërbimi në të 12 qarqet, si dhe referuar numrit të prekjeve sipas filialeve dhe zyrave postare është parashikuar disponimi i 56 autorizimeve për automjetet e blinduara që do të ofrojnë shërbimin objekt kontrate.*

Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.

- **2.3.9** Operatori ekonomik duhet të disponoje Certifikata të lëshuar nga prodhuesi i mjetit të blinduar (**kompania e specializuar për transformimin e mjeteve nga mjete normale në mjete të blinduara**) dhe Autorizime të vlefshme lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme të Policisë Shtetit ku të jete përcaktuar norma e blindimit të mjetit të blinduar për minimalisht 56 (pesëdhjetë e gjashtë) automjete të blindura, me norma blindimi sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar si me poshte.
- Për Qarkun Tiranë 10 mjete të blinduara, 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi BR6, 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR5, 4 (kater) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR4 dhe 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR3, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
- Për Qarkun Durrës 5 mjete të blinduara, 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi BR6, 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR4 dhe 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR3, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
- Për Qarkun Shkodër 5 mjete të blinduara, 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi BR6, 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR4 dhe 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR3, sipas normave Europiane të UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 për automjete të blinduar.
- Për Qarkun Lezhë 4 mjete të blinduara 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi BR6, 2 (dy) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR4 dhe 1 (një) prej automjeteve të blinduara duhet të jenë me

normë blindimi jo me te vogel se BR3, sipas normave Europiane te UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 per automjete te blinduar.

- Për Qarkun Fier 6 mjete te blinduara 1 (një) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi BR6, 2 (dy) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR4 dhe 3 (tre) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR3, sipas normave Europiane te UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 per automjete te blinduar.
- Për Qarkun Berat 3 mjete te blinduara 1 (një) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR4 dhe 2 (dy) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR3, sipas normave Europiane te UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 per automjete te blinduar.
- Për Qarkun Vlorë 4 mjete te blinduara 2 (dy) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR4 dhe 2 (dy) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR3, sipas normave Europiane te UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 per automjete te blinduar.
- Për Qarkun Gjirokastrë 3 mjete te blinduara 1 (një) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR4 dhe 2 (dy) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR3, sipas normave Europiane te UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 per automjete te blinduar.
- Për Qarkun Elbasan 6 mjete te blinduara 2 (dy) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi BR6, 2 (dy) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR4 dhe 2 (dy) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR3, sipas normave Europiane te UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 per automjete te blinduar.
- Për Qarkun Kukës 2 mjete te blinduara, 1 (një) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR4 dhe 1 (një) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR3, sipas normave Europiane te UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 per automjete te blinduar.
- Për Qarkun Peshkopi 3 mjete te blinduara 1 (një) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR4 dhe 2 (dy) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR3, sipas normave Europiane te UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 per automjete te blinduar.
- Për Qarkun Korçë 5 mjete te blinduara, 1 (një) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi BR6, 2 (dy) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR4 dhe 2 (dy) prej automjeteve te blinduara duhet te jenë me normë blindimi jo me te vogel se BR3, sipas normave Europiane te UNI EN 1522, dhe UNI EN 1063 per automjete te blinduar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ç,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në pikën 1 të nenit 32 të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në KREU VI, Ruajtja dhe

Sigurimi i Objekteve të Sektorit Bankar, Sigurimi dhe Shoqërimi i Vlerave Monetare, Materiale dhe Sendeve të Çmuara gjatë Transportit, germa C) Kategorizimi i automjeteve të blinduara dhe shoqëruese, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.

Konkretisht: Për vetë rendësinë që ka realizimi i këti lloji shërbimi me operatorë të licencuar, referuar specifikimeve teknike, numrit të prekjeve sipas qarqeve, vlerave të konsiderueshme që transportohen kryesisht nga bankat në drejtim të zyrave postare, si dhe shtrirjes në gjithë republikën, është përcaktuar edhe norma e blindimit për automjetet e blinduara që do të ofrojnë shërbimin objekt kontrate.

Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 56 (pesëdhjetë e gjashtë) shofer për drejtimin e mjeteve të blinduara emrat e të cilëve të figurojnë tek Autorizimet e Mjeteve të blinduara të lëshuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në përputhje me numrin e mjeteve të blinduara të kërkuara për çdo qark.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, germa b,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në pikën 1 të nenit 32 të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në KREU VI, Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve të Sektorit Bankar, Sigurimi dhe Shoqërimi i Vlerave Monetare, Materiale dhe Sendeve të Çmuara gjatë Transportit, germa C) Kategorizimi i automjeteve të blinduara dhe shoqëruese, pika 1. Kategori A:, germa b), të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.

Konkretisht: Për vetë rendësinë që ka realizimi i këti lloji shërbimi me operatorë të licencuar, referuar specifikimeve teknike, numrit të prekjeve sipas qarqeve, vlerave të konsiderueshme që transportohen kryesisht nga bankat në drejtim të zyrave postare, si dhe shtrirjes në gjithë republikën, është përcaktuar edhe numri i automjeteve dhe i autorizimeve të shoferave për automjetet e blinduara që do të ofrojnë shërbimin objekt kontrate.

Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 2 (dy) kuti (valixhe) për mbajtjen e banknotave me boje ngjyrosje për perballimin e situatave të emergjencave. Për të vertetur këto operator duhet të paraqesë faturen tatimore për blerjen dhe pagesën që verteton vlerën e blerjes ose deklaratën doganore të mallit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, germa ç,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 37, Pajisjet e Shërbimit, të Ligjit nr. 75 /2014 Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, në KREU VI, Ruajtja dhe Sigurimi i Objekteve të Sektorit Bankar, Sigurimi dhe Shoqërimi i Vlerave Monetare, Materiale dhe Sendeve të Çmuara Gjatë Transportit, germa B. Sigurimi dhe shoqërimi i vlerave monetare, materiale dhe sendeve të çmuara gjatë transportit, pika 8. e Udhëzimit

Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshem, ku parashikohet se: *Në kontratën ndërmjet palëve të përfshihet edhe kategoria e mjeteve të blinduara, sasia maksimale-minimale e vlerave monetare që do të transportohen gjatë një eskortimi, përdorimi i GPS-së, bojë ngjyrore me kod për çdo bankë, kamerat e regjistrimit, sinjali SOS, radio komunikimi etj.*

Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.

2.3.12 Operatori ekonomik duhet te paraqese vërtetim performance 1.3.B jo me pare se muaji Maj 2023, nga Drejtoritë e Policisë se Qarkut ku te kete punonjës te certifikuar në kategorinë 1.3.B, perkatesisht per: Tiranë 20 punonjës te certifikuar, Durrës 12 punonjës te certifikuar, Shkodër 12 punonjës te certifikuar, Lezhë 10 punonjës te certifikuar, Fier 12 punonjës te certifikuar, Berat 6 punonjës te certifikuar, Vlorë 10 punonjës te certifikuar, Gjirokastërë 6 punonjës te certifikuar, Elbasan 12 punonjës te certifikuar, Kukës 4 punonjës te certifikuar, Peshkopi 6 punonjës te certifikuar dhe Korçë 10 punonjës te certifikuar konform ligjit nr.75/2014 datë 10.07.2014) te ndryshuar si dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij. Keto vërtetime duhet te permbaje informacionin dhe opinionin qe disponon DPQ-et sa me poshte per: -Qendra e kontrollit te Shërbimeve (salle Operative) Te mos kete marre mase administrative per (operatorin ekonomik, Titullar dhe drejtues Teknik).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: *Referuar specifikimeve teknike ku kërkohet ofrim shërbimi në të 12 qarqet, ku në varësi të sasisë së vlerave monetare që do të transportohen dhe sipas normës së automjetit të blinduar është parashikuar edhe mbulimi me këtë numër punonjësish sipas qarqeve, referuar në KREU I, Procedurat për licencim, certifikim dhe ricertifikim të subjekteve të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike, germa A. Të përgjithshme, pika 11. Certifikata e punonjësit të Shërbimit Privat të Sigurisë Fizike jepet sipas nënkategorisë së licencës dhe miratimi i saj është kompetencë e drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë, ku ka vendbanimin punonjësi i shërbimit, bazuar në vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Kërkesave për Certifikim (KSHKC), të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshem.*

Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.

2.3.13 Operatori Ekonomik te disponoje Qender Kontrolli, per te vertetuar kete pike te paraqes akt miratimi sipas Udhëzimit Nr.130 dt. 05.03.2018 te Ministrit te Brendshem “Per Funkcionimin e Sherbimit Privat te Sigurise Fizike” per dymbedhete qarqe te leshuar nga DPQ-et (Tiranë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Fier, Berat, Vlorë, Gjirokastër, Elbasan, Kukës, Dibër dhe Korçë).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Kreu VII, Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të Shpsf-së, pika D. Qendra e Kontrollit, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshem, ku në pikën 5. Parashikohet: Miratimi i Qendrës së Kontrollit të SHPSF-ve bëhet nga drejtori i Drejtorisë Vendore të

Policisë, bazuar në vendimin e KSHKC-së, në çdo dy vjet, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi. Në aktin e miratimit bashkëlidhur vendoset lista e dokumentacionit dhe e pajisjeve. ***Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.***

2.3.14 Me qëllim parandalimin e veprimeve kriminale Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kapacitete sipas qarqeve si me poshtë:

- Për Qarkun Tiranë fature tatimore blerje ose deklarate doganore të mallit për 10 cope GPS; 10 cope DVR, 40 kamra dhe 20 armë zjarri
- Për Qarkun Durrës fature tatimore blerje ose deklarate doganore të mallit për 5cope GPS; 5 cope DVR, 20 kamra dhe 12 armë zjarri
- Per Qarkun Shkodër fature tatimore blerje ose deklarate doganore të mallit për 5 cope GPS; 5 cope DVR, 20 kamra dhe 12 armë zjarri
- Per Qarkun Lezhë fature tatimore blerje ose deklarate doganore të mallit për 4 cope GPS; 4 cope DVR, 16 kamra dhe 10 armë zjarri
- Për Qarkun Fier fature tatimore blerje ose deklarate doganore të mallit për 6 cope GPS; 6 cope DVR, 24 kamra dhe 12 armë zjarri
- Për Qarkun Berat fature tatimore blerje ose deklarate doganore të mallit për 3 cope GPS; 3 cope DVR, 12 kamra dhe 6 armë zjarri
- Për Qarkun Vlorë fature tatimore blerje ose deklarate doganore të mallit për 4 cope GPS; 4 cope DVR, 16 kamra dhe 10 armë zjarri
- Për Qarkun Gjirokastërë fature tatimore blerje ose deklarate doganore të mallit për 3 cope GPS; 3 cope DVR, 12 kamra dhe 6 armë zjarri
- Për Qarkun Elbasan fature tatimore blerje ose deklarate doganore të mallit për 6 cope GPS; 6 cope DVR, 24 kamra dhe 12 armë zjarri
- Për Qarkun Kukës fature tatimore blerje ose deklarate doganore të mallit për 2 cope GPS; 2 cope DVR, 8 kamra dhe 4 armë zjarri
- Për Qarkun Peshkopi fature tatimore blerje ose deklarate doganore të mallit për 3 cope GPS; 3 cope DVR, 12 kamra dhe 6 armë zjarri
- Për Qarkun Korçë fature tatimore blerje ose deklarate doganore të mallit për 5 cope GPS; 5 cope DVR, 20 kamra dhe 10 armë zjarri

Operatori Ekonomik për të vërtetuar faktin e pronësive të armëve duhet të disponojë gjithashtu dhe dokumentacionin si me poshtë:

- Autorizim nga drejtorja e pergjithshme e policisë për blerjen e armëve të zjarrit.
- Kontrata Shitblerje Armë me një shoqëri të licensuar
- Fature tatimore për blerjen e armëve.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në Kreu VII, Uniforma, Mjetet, Pajisjet e Shërbimit, Dokumenti i Identifikimit të Punonjësit të Shpsf-së, pika B. Mjetet dhe pajisjet e shërbimit, pika 3, dhe germa D. Qendra e Kontrollit, të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm.

Kjo kërkesë është për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike për të zbatuar kontratën.

Specifikimet teknike të procedurës për “**Shërbimi i Transportit, Shoqërimit dhe ruajtjes së vlerave monetare gjatë transportit, me roje të kategorisë 1.3.B**”, janë hartuar mbi bazën e **Urdhërit të brendshëm Nr. 43**, datë **21.07.2023**, të Administratorit të “Posta Shqiptare” sh.a.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të procedurës për “**Shërbimi i Transportit, Shoqërimit dhe ruajtjes së vlerave monetare gjatë transportit, me roje të kategorisë 1.3.B**”, janë hartuar mbi bazën e **Urdhërit të brendshëm Nr. 43**, datë **21.07.2023**, të Administratorit të “Posta Shqiptare” sh.a., në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar).

Specifikimet teknike të shërbimit objekt prokurimi janë hartuar duke u diktuar nga nevoja për

Ruajtjen, transportimin dhe shoqërimin e vlerave monetare të **Postes Shqiptare sh.a.**, sipas kategorive të eskortave në bazë të Udhëzimit Nr.130 datë 05.03.2018 të Ministrit të Brendshëm dhe në bazë të marrëveshjes paraprake mes palëve për përcaktimin e kategoris së eskortës sipas qyteteve përkatës në përputhje me vlerat që qarkullojnë.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës i ngritur me urdherin e administratorit nr. 43, datë 21.07.2023, u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76 “**Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit**”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar) ku parashikohet se:

1. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:
 - a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
 - b) **studimit të tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
 - c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
 - ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e

tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

*Bazuar në germen b) të pikes 1, të nenit 76 “Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar), grupi i punës, ka realizuar *studimin e tregut*, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; dokumentacion i cili gjendet në dosjen e tenderit dhe ka përlogaritur vlerën limit të kontratës.*

NJËSIA E PROKURIMIT